

01 016-37352/26
18.05.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjiçan
Gilan Belediyesi

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika (d) dhe nenit 14, paragrafi 1 i Ligjit nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/15 Qershor 2008), e në zbatim të nenit 21, paragrafi 1, pika 1.1 të Ligjit nr.06/L-092, "Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës" (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.10/03 Prill 2019), nenit 24, paragrafit 1, 2 dhe 3 si dhe nenit 25, paragrafit 1, pika 1.1 dhe 1.2 të "Rregullores (QRK) nr.09/2020 Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës" (Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.06/20 datës 05.08.2020), nenit 37, paragrafi 1, pika 1.3 të Statutit të Komunës së Gjiçanit (01nr.016-126211 i dt.06.11.2014 me Ndryshimet dhe Plotësimet e Statutit 01.nr.016-28448 të datës 22.03.2018, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit, në mbledhjen e mbajtur me datë 18.05.2026, miratoi këtë :

V E N D I M

Për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër (5 vite) ish-objektin e QKMF-së, Policisë së Kosovës - Drejtorisë Rajonale të Policisë në Gjiçan.

1. Aprovohet propozimi i Kryetarit të Komunës 02.Nr.263 i datës 08.04.2026 për miratimin e kërkesës 06.Nr.155-1 të datës 31.03.2026 e Ministrisë së Punëve të Brendshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës, për marrjen në shfrytëzim të objektit të ish QKMF-së në Gjiçan për nevoja të Drejtorisë Rajonale të Policisë në Gjiçan.

2. Sipas pikës 1 të këtij vendimi, prona e paluajtshme e komunës e cila do të ipet në shfrytëzim është ndërtuar në këto njësi kadastrale :

- 2.1. Njësia kadastrale P-70403013-03558-0 me sipërfaqe prej 30 m², lloji i njësisë: parcelë, lloji i pronës: pronë shoqërore, vendi i quajtur Gjiçan, Bulevardi Ibrahim Rugova, pronar: Komuna e Gjiçanit.
- 2.2. Njësia kadastrale P-70403013-03559-1 me sipërfaqe prej 928 m², lloji i njësisë: parcelë, lloji i pronës: pronë shoqërore, vendi i quajtur Gjiçan, Bulevardi Ibrahim Rugova, pronar: Komuna e Gjiçanit.
- 2.3. Njësia kadastrale P-70403013-03559-2 me sipërfaqe prej 70 m², lloji i njësisë: parcelë, lloji i pronës: pronë shoqërore, vendi i quajtur Gjiçan, Bulevardi Ibrahim Rugova, pronar: Komuna e Gjiçanit.

3. Pronat e propozuara ipen në shfrytëzim për periudhën afatshkurtër (5 vite) si rast i veçantë pasë kërkesës së Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës, për nevoja të zhvendosjes së Drejtorisë Rajonale të Policisë në Gjilan nga se objekti i tyre i vjetër tanimë është rrënuar për shkak të implementimit të Projektit "Bulevardi i Qytetit".
4. Shfrytëzimi i pronës komunale nga ana e Policisë së Kosovës bëhet pa kompensim me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për punë personelit të DRP Gjilan, e deri në zgjidhjen definitive të objektit të ri të Drejtorisë Rajonale.
5. Komuna e ruan të drejtën e saj për përmbushjen e interesit publik dhe politikave zhvillimore lidhur me pronat në fjalë edhe para skadimit të këtij afati prej 5 vite.
6. Pas plotëfuqishmërisë së këtij Vendimi, Kryetari i Komunës autorizohet që të lidhë kontratë mbi vazhdimin e shfrytëzimit edhe për 5 vite të kësaj prone me përfaqësuesin e autorizuar të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës me të cilin do të përcaktohen të gjitha kushtet lidhur me shfrytëzimin e këtyre hapësirave.
7. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që pas plotëfuqishmërisë së këtij Vendimi të evidenton në Regjistrat Kadastral dhënien në shfrytëzim të pronës komunale për raste të veçanta Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës- Drejtorisë Rajonale të Policisë Gjilan.
8. Për zbatimin e këtij vendimi, kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria e Shëndetësisë, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal Gjilan.
9. Ky Vendim hynë në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

01.Nr. 016-37352/26

Gjilan, më 18.05.2026



Kryesuesja e KK Gjilan

[Signature]
/Krenare Latifi-Kajiku/